



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.05-400/01-38144/21
Kaçanik: 29.12.2021

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 Dhjetor 2021, pos tjerash, u ;

NJOFTUA

1. Me Raportin Nëntëmujor Financiar për periudhën Janar- Shtator 2021, i hartuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.
2. Në Raportin ,si në pikën 1 të kësaj shkrese janë prezantuar Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme të Buxhetit të Komunës së Kaçanikut ,për periudhën Janar – Shtator 2021.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është ; “Raporti Nëntëmujor Financiar, për periudhën Janar – Shtator 2021” / Lënda 01Nr.05-400/01-38144/21.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Murseli



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçaniku

Opština Kacanik - Municipal Kaçanik

I	Data 20.12.21	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
05	400/01-38144/1	

RAPORTI NËNTËMUJOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Shtator

2021

DREJTORIA PËR EKONOMI FINANCA DHE ZHVILLIM

Për Kuvendin
Komunal

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Kaçanik, Dhjetorë 2021

I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2021:

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2021 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Organizata Buxhetore e Komunës së Kaçanikut – KO 652, sikundër në tremujorin e parë, ashtu edhe gjatë 9 mujorit të këtij viti vijues, ka vazhduar njëjtë së funksionari sikurse në vitin parapark, duke menaxhuar dhe operuar me mjete buxhetore në trembëdhjetë (13) Programe Buxhetore (PB):

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Shërbimet Publike dhe Emergjencat,
6. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
7. Planifikimi Urban dhe Mjedisi,
8. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
9. Arsimi dhe shkenca,
10. Zyra Lokale për Komunitete,
11. Zhvillimi ekonomik,
12. Kultura, rinia dhe sportet dhe
13. Shërbimet sociale dhe rezidenciale.

Me qëllim të kompletimit sa më të mirë të këtij raporti, përmes dhënies së sqarimeve plotësuese mbi trendet e realizuara të mjeteve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2021 dhe krahasimit me periudhën e njëjtë të vitit parapark, në vazhdim bëjmë shpalosjen e Pasqyrave Financiare përmes tabelave të paraqitura në vijim:

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2021

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2021								
TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2021	Buxheti i tanishëm 2021	Shpenzimet 31.09-2021	Shpenzimet 31.09-2020	Progresi në %	Krahasimi 2021/20 në €	Indeksi 2021/2020 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A	TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	8,135,944.00	8,135,944.00	5,029,291.20	4,953,808.37	61.82	75,482.83	1.52
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	3,305,460.00	3,305,460.00	1,188,467.20	2,138,240.04	35.95	(949,772.84)	(44.42)
2	GRANTI I ARSIMIT	3,669,480.00	3,669,480.00	3,017,810.00	2,021,338.43	82.24	996,471.57	49.30
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,161,004.00	1,161,004.00	823,014.00	794,229.90	70.89	28,784.10	3.62
B	TOTAL TE HYRAT VETANAKE- PARTICIPIMET DHE DONACIONET	646,655.00	1,153,007.72	388,537.87	137,272.87	33.70	251,265.00	183.04
4	TË HYRAT KOMUNALE TË VITIT 2021	646,655.00	646,655.00	208,830.26	96,888.87	32.29	111,941.39	115.54
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI 2020	-	506,352.72	179,707.61	34,227.00	35.49	145,480.61	-
6	PARTICIPIMET DHE GRANTET E BARTURA NGA DONATORËT DHE HUAMARRJA	-	-	-	6,157.00	-	(6,157.00)	-
TOTALI (A+B)		8,782,599.00	9,288,951.72	5,417,829.07	5,091,081.24	58.33	326,747.83	6.42

Tabela 1 – pasqyrohet gjendja e Buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal, Buxheti i Rishikuar në fillim të vitit (me rastin e startimit të këtij viti buxhetor është bërë bartja definitive e të hyrave nga viti 2020, si bilance të pashpenzuara në vitin parapark, pastaj në kolonat vijuese janë pasqyruar shpenzimet aktuale sipas prerjes më 30.09.2021, shkalla e realizimit të mjeteve buxhetore e shprehur në (%), si dhe prezentimi dhe *vënia në raport* e shpenzimeve të realizuara në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Buxheti fillestar i miratuar në shtator 2020, për vitin 2021 ishte në shumën totale prej **8,782,599.00 €**, ndërsa shuma prej **9,288,951.72€**, nga të dhënat e kolonës 2, ka të bëjë me buxhetin e shtuar gjatë këtij viti – buxheti aktual.

Në kolonën 3, është pasqyruar shpenzimi i mjeteve të përgjithshme gjatë kësaj periudhe të këtij vitit raportues prej **5,417,829.07€**. Shikuar sipas burimeve të mjeteve, mjetet e shpenzuara nga granti qeveritar, kemi shumën prej 5,029,291.20€ apo një përmbushje buxhetore prej 61.82%, nga mjete të të hyrave vetanake të vitit 2021, shuma prej 208,830.26€ ose 32.29%, nga të hyrat vetanake të bartura nga viti 2020, shuma prej 179,707.61€ ose 35.49% dhe nga participimet, donatorët dhe huamarrjet shum prej 6,157.00.

Në kolonën 4, kemi prezentuar shpenzimet e realizuar të periudhës së njëjtë të vitit 2020, të cilat janë në shumë prej **5,091,081.24€**, që sipas indeksave të realizuar, siç pasqyrohen në kolonën 6 dhe 7, shpenzimet e sivjetme në raport të njëjtë me ato të vitit paraprak, në këtë vit, shënojnë rënie për 6.42% apo shprehur ne masë monetare prej 326,747.83€.

